

Pavarësisht se në Shqipëri, në vitin 2015 është miratuar nga qeveria Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e Veprimit, ka një sërë faktorësh që rrisin rrezikun për ekstremizmin e dhunshëm. Ekstremizmi i dhunshëm lidhet sidomos me edukimin, barazinë dhe ekonominë. Sipas të dhënave të Bankës Botërore 35 % e popullsisë në Shqipëri jeton *në varfëri*, duke rritur mundësinë e përkrahjes së grupeve ekstremiste. Ndërkaq, përsa i përket edukimit, pavarësisht rritjes së të personave që arsimohen, ka një *mosakordim mes sistemit arsimor dhe ekonomisë në vend*, duke sjellë rritje të *papunësisë* afatgjatë dhe ulje të të ardhurave.<sup>1</sup> Një faktor i rëndësishëm që sjell zhvillimin e ekstremizmit të dhunshëm është edhe *përrjashtimi social*. Në vendin tonë, ndryshimet strukturore të dekadave të fundit në punësim, urbanizim, migrim, përbërje familjare, kanë çuar në nivele më të larta të individualizimit dhe përrjashtimit të të rinjve nga lidhjet shoqërore. Strukura politike është një faktor që lidhet me ekstremizmin e dhunshëm, ku problemet më të mëdha lidhen me regjimin hibrid,<sup>2</sup> **korruptionin** dhe të qenit një vend *‘pjesërisht i lirë’*. Ndërkohë, pavarësisht se në Shqipëri, ekziston pritja për tolerancë dhe bashkëjetesë fetare, studimet kanë evidentuar *se shenjat e dukshme të besimit fetar*, si shamia e kokës dhe burka që veshin gratë dhe mjekrat që mbajnë burrat janë çështje debatesh të nxehta në sferën publike, të lidhura, e fundamentalizmin dhe ekstremizmin fetar.<sup>3</sup> Kështu, nga analizimi i situatës evidentohet se nxitësit social-ekonomikë, politikë, ideologjitë fetare përbëjnë kërcënim për zhvillimin e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Rrjedhimisht është e nevojshme implementimi i ndërhyrjeve parandaluese dhe fuqizimi i komunitetit.

Per me shume info: Study “Violent Extremism in Albania” (2018)

---

<sup>1</sup> INSTAT, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim & UNFPA (2015) Të rinjtë në Shqipëri: Sfidat në kohët që ndryshojnë. Tiranë.

<sup>2</sup> <https://infographics.economist.com/2018/DemocracyIndex/>

<sup>3</sup> Study “Violent Extremism in Albania” (2018)